



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 218, datë 09.10.2024

PËR

**“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT PËR
PROKUROREN MARJETA ZAIMI”**

Bazuar në nenet 149/a, germa “e”, 149/ç, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenin 9 të ligjit Nr. 96/2016 *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, nenin 164, pika 8, nenin 189, pika 1, germa “a”, të ligjit Nr. 115/2016 *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, i ndryshuar, nenin 8 të Rregullores *“Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”*, si dhe pasi u njoh me relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit për prokuroren Marjeta Zaimi, si pedagoge e jashtme në Shkollën e Magjistraturës, për lëndën “I mituri dhe viktima”, me një ngarkesë prej 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) orë pune, për vitin akademik 2024 – 2025.
2. Të njoftohen për këtë vendim prokurorja Marjeta Zaimi, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 09.10.2024.

KRYETAR

Mirela Bogdani

